

VENDIM
Nr. 284, datë 10.5.2019

**PËR PEZULLIMIN E PËRKOHSHËM TË FILLIMIT TË PROCEDURAVE TË
PROKURIMIT NGA NJËSITË E VETËQEVERISJES VENDORE DHE
AUTORITETET KONTRAKTORE NË VARËSI TË TYRE, PËR PERIUDHËN 1
DERI 30 QERSHOR 2019**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 16 e 40, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pezullimin e përkohshëm të fillimit të procedurave të prokurimit nga njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe autoritetet kontraktore në varësi të tyre, për periudhën 1 deri 30 qershor 2019.

Përfshihen nga ky rregull:

- prokurimet me vlerë të vogël;
- procedurat e prokurimit që kanë si objekt produktet ushqimore.

2. Ngarkohen të gjitha institucionet e vetëqeverisjes vendore, institucionet në varësi të tyre dhe Agjencia e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama